

V E N D I M
Nr. 564, datë 23.10.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.743, DATË 18.12.1995, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR RRITJEN E ÇMIMEVE TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR PËRDORUESIT JOFAMILJARË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18, pika 4, të ligjit nr.7962, datë 13.7.1995, “Për energjinë elektrike” dhe të nenit 12, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.7970, datë 20.7.1995 “Për rregullimin e sektorit të energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.743, datë 18.12.1995, të Këshillit të Ministrave, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Çmimi i shitjes për përdoruesit jofamiljarë, të jetë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi”

2. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për “Elektriku”, sh.a., Elbasan, “Elektriku Vlorë”, sh.a. dhe “Sesa Shkodër” sh.a. , të jetë 3 (tre) lekë për çdo kilovat/orë.

3. Ngarkohet KESH, sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

ÇMIMET E SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

DEGËT EKONOMIKE	Në fuqi	Propozohen
A. Përdoruesit familjarë	4	4
B. Sektorët kryesorë të ekonomisë	3	4.5
nafta, kromi, bakri, siderurgjia, gjeologjia,etj.	3	4.5
C. Subjektet e prodhimit të bukës	3	4.5
Ç. Subjektet e tjera prodhuese		
1.Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kV)	4.1	5.6
2.Furnizimi nga rrjeti TM (6,10 dhe 20 kV)		
a) matja në n/st	5.3	7
b) matja në primarin e transformatorit		
c) matja në sekondarin e transformatorit	5.4	7.3
3. Furnizimi nga rrjeti i TU	5.6	7.5
D. Subjekte të tjera të shërbimit, tregtimit, hotele, ente, zyra ,etj.	6.3	8.5
I. Periudha Prill-Tetor		
1.Furnizimi nga rrjeti TL (35 dhe 110 kV)	0	0
2. Furnizimi nga rrjeti TM (6,10, 20kV)		
a) matja në n/st	5.1	6.5
b) matja në primarin e transformatorit	5.3	7
ç) matja në sekondarin e transformatorit	5.5	7.5
3. Furnizimi nga rrjeti i TU	6.3	8.5
II. Periudha Nëntor-Mars		
1.Furnizimi nga rrjeti i TL (35 dhe 110 kV)	0	0
2. Furnizimi nga rrjeti i TM (6,10 dhe 20 kV)		
a) matja në n/st	7.4	9
b) matja në primarin e transformatorit	7.7	9.2
ç) matja në sekondarin e transformatorit	8.1	9.6

3. Furnizimi nga rrjeti i TU
Filialet pilot

10.1
1

12
3